

**20130892090**

**MINISTRIA E PUNEVE TË BRENDSHME**

Në bazë të nenit 79 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për Siguri Private ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/12), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

**RREGULLORE  
PËR LLOJET DHE TIPAT E ARMËVE TË ZJARRIT DHE MJETEVE TË TJERA TË  
DETYRIMIT PËR NEVOJAT E PERSONAVE JURIDIKË QË KRYEJNË SIGURI  
PRIVATE, NUMRI I ORËVE TË TRAJNIMIT PËR QITJE ME ARMË ZJARRI DHE  
FORMA DHE PËRMBAJTJA E URDRIT PËR ARMËMBAJTJE**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore përshkruhen llojet dhe tipat e armëve të zjarrit dhe mjetet e tjera të detyrimit për nevojat e personave juridikë që kryejnë siguri private, numri i orëve për trajnimin e qitjes me armë zjarri dhe formën dhe përmbajtjen e urdhrin për armëmbajtje.

**Neni 2**

Personat juridikë që kryejnë siguri fizike për nevojat e sigurisë mund të blejnë llojet dhe tipat e mëposhtme të armëve të zjarrit:

1. Armë zjarri gjysmë automatike ose me breshëri të shkurtra me tuba me spirale të centralizuar (pistoleta ose revole) në përputhje me nenin 4 paragrafi 4 pika 1 të Ligjit për Armët ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/05, 47/06, 42 / 07, 86/08, 72/10 dhe 158/11) dhe neni 3-b alineja 1 e Rregullores për llojet e armëve që mund të prokurohen në bazë të miratimit dhe rëndësisë së llojeve të caktuara të armëve nga kategoria A dhe D ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/07 dhe 2/11) dhe

2. Armë zjarri gjysmë automatike me tub spirale ose armë zjarri e gjatë me tub brazdë (pushkë ose karabinë) ose me ndezje të centralizuar dhe gjysmë automatike ose breshëri të gjata me tub jospirale (pushkë me saçme) me ndezje të centralizuar në përputhje me nenin 4, paragraf 4, pika 4 5, 6, 7 dhe neni 4, paragrafi 5 pikat 1 dhe 3 të Ligjit për armë ("Gazeta zyrtare Republikës së Maqedonisë" nr. 7/05, 47/06, 42/07, 86/08, 72/10 dhe 158 / 11) dhe neni 3, alineja 1, 2, 3, 4, 6 dhe neni 3-a dhe alineja 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores mbi llojet e armëve që mund të jenë të prokurohen në bazë të miratimit dhe për rëndësinë e llojeve të caktuara të armëve të kategorisë A dhe D ("Gazeta zyrtare e Republikës e Maqedonisë" nr. 51/07 dhe 2/11).

**Neni 3**

Personat juridik që kryejnë siguri private, për nevojat e sigurisë mund të blejnë këto lloje dhe tipa të mjeteve të detyrueshme:

1. Mjete për lidhje të personave: pranga dhe **pirgje plastike**,

2. Mjete kimike (sprej): Forma joeksplozive të lëngshme të atomizatorëve ose forma të atomizatorëve me gaz që nën presion nxjerrin lëngun ose gazin, e të cilat kanë efekt afatshkurtër në shëndetin e njeriut;

3. Qeni i trajnuar: një qen për të cilin Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar një certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit, një certifikatë për nivelin e kryerjes së aftësisë

së punës së qenit të trajnuar të marrë nga jashtë vendit ose një certifikatë për kryerjen e suksesshme të aftësisë së punës së qenit të trajnuar që kryen punën e sigurisë private

Neni 4

Punonjësit e sigurisë që kryejnë siguri fizike mund të armatosen me armë zjarri të përmendura në nenin 2 pika 1 të kësaj Rregulloreje.

Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, punonjësit e sigurisë që kryejnë siguri fizike mund të armatosen edhe me armë zjarri, të referuara në nenin 2 pika 2 të kësaj Rregulloreje, kur ato sigurojnë:

- objekte me rëndësi jetike jashtë vendbanimit, në hapësirë në qiell të hapur dhe
- transport të parave dhe artikujve të tjerë të vlefshëm.

Neni 5

Aftësimi për qitje me armë të zjarrit i referuar në nenin 2 të kësaj Rregulloreje, bëhet për një periudhë prej shtatë orësh.

Neni 6

Urdhri për të mbajtur armë zjarri, do të lëshohet në formë të shtypur në letër me ngjyrë të bardhë me dimensione 11x15 cm.

Pjesa e përparme e formularit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë: numrin dhe datën, emri "URDHËR PËR ARMËMBAJTJE", të dhënat për personin juridik (emri dhe selia), të dhënat për të punësuarin (emri dhe mbiemri), të dhënat për lejen (numri dhe autoriteti që e ka lëshuar), të dhënat për legjitimacionin identifikues të sigurisë private (numri dhe autoriteti që e ka lëshuar) të dhënat e armës (numri, kategoria, shenja, modeli, kalibri dhe numri i fabrikës), të dhënat e urdhrin (vendi dhe validiteti), vendi i nënshkrimit të personit përgjegjës, për vulën dhe nënshkrimin e punonjësit

Pjesa e prapme e formularit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë: tekstin e shtypur

"Punonjësi i sigurimit privat është i detyruar të mbajë urdhrin për armëmbajtje dhe lejen për armëmbajtje. Punonjësi i sigurimit privat është i detyruar të mbajë armë dhe ta përdorë atë në përputhje me Ligjin për Sigurinë Private, Ligjin mbi Armët dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje. Për mosrespektimin e dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, punonjësi është përgjegjës për veprë penale, kundërvajtëse, materiale dhe disiplinore për shkeljet e kryera. Punonjësi është i detyruar të kërkojë trajnim dhe trajnim shtesë, nëse ai konsideron se është i nevojshëm për mbajtjen dhe trajtimin e duhur, si dhe përdorimin e armës. Personi përgjegjës në personin juridik është i detyruar, me kërkesë me shkrim nga i punësuarin, të sigurojë një trajnim të tillë dhe vetëm më pas të lëshojë urdhër të punonjësi dhe ta ngarkojë atë me armë të tilla".  
Formulari i referuar në paragrafin 1 të këtij neni është bashkëngjitur dhe është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

Neni 7

Në ditën e fillimit të zbatimit të kësaj Rregulloreje, përfundon vlefshmëria e Rregullores për llojet dhe tipat e armëve të zjarrit për nevojat e personave juridikë që sigurojnë sigurinë e personave dhe të pronës dhe numri i orëve për trajnimin në qitje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46 / 08 dhe 155/08).

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të fillojë të zbatohet nga data 3 korrik 2013.

Nr. 12. 1 –39332/1  
20 qershor 2013  
Shkup

Ministër  
i Punëve të Brendshme,  
m-r Gordana Jankulovska,n.p

Pjesa e përparme

Numër \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Urdhër për armëmbajtje

Personi juridik \_\_\_\_\_  
me seli \_\_\_\_\_  
lëshon urdhrin për armëmbajtje punonjësit për siguri

Emir dhe mbiemri  
Me leje për armëmbajtje  
me numër \_\_\_\_\_ lëshuar nga

Me legjitimacion për siguri private me numër \_\_\_\_\_  
E lëshuar nga Oda e Republikës së Maqedonisë për  
siguri private

**që të mbajë armë që e posedon personi juridik  
me leje posedimi të armëmbajtjes me numër \_\_\_\_\_**

- **Kategoria** \_\_\_\_\_
- **Marka** \_\_\_\_\_
- **Modeli** \_\_\_\_\_
- **Kalibri** \_\_\_\_\_
- **Numri i fabrikës** \_\_\_\_\_
- **Vendi i mbajtjes së armës:**

Urdhri vlen deri \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ V.V.

Personi përgjegjës

Punonjësi për siguri private

Pjesa e pasme

Punonjësi i sigurimit privat është i detyruar të mbajë urdhrin për armëmbajtje dhe lejen për armëmbajtje.

Punonjësi i sigurimit privat është i detyruar të mbajë armë dhe ta përdorë atë në përputhje me Ligjin për Sigurinë Private, Ligjin mbi Armët dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje.

Për mosrespektimin e dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, punonjësi është përgjegjës për vepër penale, kundërvajtëse, materiale dhe disiplinore për shkeljet e kryera.

Punonjësi është i detyruar të kërkojë trajnim dhe trajnim shtesë, nëse ai konsideron se është i nevojshëm për mbajtjen dhe trajtimin e duhur, si dhe përdorimin e armës.

Personi përgjegjës në personin juridik është i detyruar, me kërkesë me shkrim nga i punësuar, të sigurojë një trajnim të tillë dhe vetëm më pas të lëshojë urdhër te punonjësi dhe ta ngarkojë atë me armë të tilla".